



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË  
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN  
E MINIERAVE DHE INDUSTRIJË

Nr. 2945/Prot.

Tiranë, më 19.04.2024

Lënda: Njoftim për fillimin e procedurave për revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1127/1, datë 08.01.2008.

**SHOQËRISË “C.F.F” SH.P.K**

**Lip, Përmet, Gjirokastrë.**

**Për dijëni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE  
Blloku “Vasil Shanto”, Nr.18, Tiranë.**

**AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË  
MINIERA**

**Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë.**

Shoqëria “C.F.F” sh.p.k, është zotëruese e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1127/1, datë 08.01.2008, për mineralin ranor pllakor, në Objektivin “Lipe”, Bashkia Përmet, Qarku Gjirokastrë.

Nga struktura përgjegjëse, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, me shkresën Nr. 1830, datë 27.03.2024, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me Nr. 2945, Prot., datë 29.03.2024, është propozuar revokimi i Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1127/1, datë 08.01.2008, për mineralin ranor pllakor, në Objektivin “Lipe”, Bashkia Përmet, Qarku Gjirokastrë, pasi nuk ka respektuar kërkesat e legjislacionit minerar, lidhur me pagesën e garancisë financiare të rehabilitimit të mjedisit për vitin 2024.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, është i mbështetur në Nenin 47, pika 1, gërma “ç” të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Sa më sipër, në zbatim të Nenit 48, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë për fillimin e procedurave të revokimit për Lejen Minerare të Shfrytëzimit** Nr.1127/1, datë 08.01.2008, për mineralin ranor pllakor, në Objektivin “Lipe”, Bashkia Përmet, Qarku Gjirokastrë, që shoqëria Juaj zotëron.

Referuar pikës 2, neni 48 “Procedura e revokimit të lejes”, keni të drejtë që, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e njoftimit, sipas kushteve të paragrafit të mësipërm, të paraqesë sqarime për shkaqet e përmendura në njoftim për fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare.

Ju bëjmë me dije se, Ministri, do të marrë vendim mbi revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1127/1, datë 08.01.2008, për mineralin ranor pllakor, në Objektivin "Lipe", Bashkia Përmet, Qarku Gjirokastrë, 30 ditë kalendarike pas kalimit të afatit të përcaktuar në pikën 2, neni 48 "Procedura e revokimit të lejes", të ligjit Nr. 10 304, datë 15.07.2010 "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!

**MINISTRI**  
**BELINDA BALLUKU**  
**ME AUTORIZIM**  
**ZËVENDËSMINISTRI**  
**ENKELEJDA MUÇAJ**